

Vendim nr. 181 datë 18.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska, Kryesuese

Genti Ibrahimimi, Anëtar

Sonila Bejtja, Anëtare

në datën 18.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (Y) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **YLBER BAKU**, përfaqësuar me prokurë nga avokat Tauland Asllanaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 4928, datë 19.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 3988, datë 22.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-5612, datë 14.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 31, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 296, 298, 399/1 – 399/12, 472, pika 1, shkronja “a”, 475 dhe 485/a të Kodit të Procedurës Civile; ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e

**Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi rezulton se ka ushtruar detyrën e inspektorit të pyjeve dhe kullotave në sektorin pyjor Bizë, pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor (*DSHP*), Tiranë (aktualisht Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Drejtoria Rajonale Tiranë), në varësi të Ministrisë së Mjedisit (aktualisht Ministria e Mjedisit dhe Turizmit). Po kështu, rezulton se marrëdhëniet tij me punëmarrësin, DSHP-në, Tiranë, kanë zgjatur deri më 24.10.2013.

2. Bazuar në urdhrin nr. 763 prot., datë 07.10.2013 të DSHP-së, Tiranë është ushtruar kontroll në Peizazhin e Mbrojtur Mali me Gropa, Bizë-Martanesh, Mali i Dajtit, Krrabë Qendër, zonë e cila kontrollohej dhe ruhej nga kërkuesi. Nga ky kontroll ka rezultuar se ishin prerë 536 drurë, nga të cilat kërkuesi kishte të justifikuar vetëm 161 pemë. Për rrjedhojë, DSHP-ja, Tiranë, bazuar në ligjin nr. 9358, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me shkresën nr. 819 prot., datë 16.10.2013, ka propozuar lirimin nga detyra të kërkuesit.

3. Me urdhrin nr. 1022, datë 24.10.2013 të ministrit të Mjedisit (*urdhri nr. 1022/2013*), kërkuesi është liruar nga detyra me motivacion “ka dëmtime të shumta të lëndës drusore në zonën e tij”. Për këtë arsye, duke pretenduar se zgjidhja e kontratës së punës është e menjëhershme, pa shkak të justifikuar dhe në shkelje të procedurës së parashikuar nga Kodi i Punës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesëpadi me objekt pavlefshmërinë e urdhrin nr. 1022/2013 dhe detyrimin e DSHP-së, Tiranë ta dëmshpërblejë me 18 paga mujore në total.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4928, datë 19.09.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 3988, datë 22.11.2016, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5612, datë 14.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

5. Në datën 26.06.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 15.07.2024.

6. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

- 7.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka anashkaluar prova të rëndësishme shkresore (procesverbalet e mbajtura nga kërkuesi në kryerjen e detyrës) të paraqitura nga kërkuesi dhe të lëna të pashqyrtuara edhe nga dy gjykatat më të ulëta. Edhe gjykatat e faktit nuk i kanë vlerësuar procesverbalet e mbajtura nga kërkuesi për 352 drurë të prerë, të cilat ai i kishte konstatuar nga këqyrja dhe kontrolli sistematik i zonës.
- 7.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi gjykatat nuk kanë pranuar të marrin në shqyrtim, të analizojnë dhe të vlerësojnë provat e paraqitura nga kërkuesi, ndërkohë që kanë pranuar, kanë marrë në shqyrtim dhe kanë vlerësuar të njëjtat prova të paraqitura nga pala e paditur, duke e mbështetur vendimmarrjen e tyre në to.
- 7.3. *Parimit të barazisë së armëve*, për shkak se gjykatat nuk kanë bërë pjesë të vlerësimit, analizës dhe arsyetimit provat shkresore të depozituara nga kërkuesi, duke e mbështetur qëndrimin e tyre vetëm në provat e paraqitura nga pala e paditur në proces, për rrjedhojë duke e vendosur kërkuesin në pozita haptazi të disfavorshme në krahasim me palën tjetër. Ky pretendim nuk është marrë në shqyrtim dhe nuk është arsyetuar as nga Gjykata e Lartë.
- 7.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit për konstatimin e cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshem, parimit të paanshmërisë dhe atij të barazisë së armëve. Vendimi i Gjykatës së Lartë është alogjik dhe nuk ka koherencë në pjesët e tij.

7.5. Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar çështjen pas 2 vjetëve. Ky pretendim është ngritur edhe në Gjykatën e Lartë, por ajo nuk i ka dhënë përgjigje. Ndërkohë, edhe vetë Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen përtej afatit të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 05.04.2017 dhe është marrë në shqyrtim prej saj në datën 14.11.2023, pra pas 6 vjetësh e 6 muajsh nga regjistrimi i saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuetit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkueti të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kërkueti, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, vërehet se kërkueti i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

12. Kolegji, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin nr. 00-2023-5612, datë 14.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 26.06.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar). Në lidhje me këtë fakt, kërkuesi ka argumentuar se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, pasi vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i është njoftuar atij në muajin mars të vitit 2024. Ndërkohë, referuar materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i është komunikuar në datën 14.02.2024, në adresën elektronike (*e-mail*), përfaqësuesit të kërkuetit, shtetasit E.K., të zgjedhur prej tij (kërkuetit) me prokurën e posaçme të datës 09.11.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 26.06.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar). Për rrjedhojë, vërehet se ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë pas 4 muajsh e 12 ditëve nga njoftimi i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

13. Për sa më lart, referuar edhe jurisprudencës kushtetuese (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*) Kolegji vlerëson së llogaritja e afatit 4-mujor për efekt të paraqitjes së ankimit kushtetues individual do të konsiderohet data 14.02.2024, kur vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i është komunikuar me anë të njoftimit elektronik përfaqësuesit të kërkuetit. Në këtë kuptim, duke iu referuar kësaj date, ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk plotëson kriterin *ratione temporis*, pasi është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Për sa më sipër, për sa kohë kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kriterëve të tjera të pranueshmërisë së kërkesës.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.